REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke e konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke e vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2024 dhe vlerëson:

Rritjen me 32.9% të numrit të ankesave të shqyrtuara në krahasim me vitin 2023, çka dëshmon për rritjen e besueshmërisë së operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore në funksionimin e këtij institucioni.

Nxjerrjen e vendimeve të themelit dhe vendimeve interpretuese, të cilat kontribuojnë në unifikimin e praktikave administrative dhe në zgjidhjen efektive të mosmarrëveshjeve në fushën e prokurimit publik.

Përshtatjen e proceseve drejt përdorimit të gjerë të sistemeve elektronike për dorëzimin dhe menaxhimin e ankesave, i cili konsiderohet një përparim i rëndësishëm drejt modernizimit institucional dhe rritjes së aksesit për operatorët ekonomikë.

Përdorimin e nënshkrimit elektronik dhe përpjekjet për digjitalizimin e dokumentacionit si hapa thelbësorë për përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës.

Organizimin e seancave dëgjimore me përdorimin e sistemeve bashkëkohore të regjistrimit audio, të cilat përbëjnë një avancim në standardet e transparencës dhe profesionalizmit në shqyrtimin e çështjeve.

Publikimin e historikut të vendimeve sipas standardeve ndërkombëtare, digjitalizimi i arkivave dhe zhvillimi i aplikacionit mobile për lehtësimin e procedurave, të cilët përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së aksesit publik dhe transparencës.

Angazhimin aktiv institucional në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përpjekjet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes trajnimeve.

Kuvendi kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1.Të vijojë përmirësimi i metodave të punës, analizimi dhe adresimi i problematikave që dalin nga praktika, duke synuar një harmonizim më të plotë me standardet evropiane të kontrollit dhe ankimimit në fushën e prokurimeve publike, në përputhje me vlerësimet pozitive të pasqyruara në progresraportin e Bashkimit Evropian dhe të SIGMA-s.

2.Të intensifikohet bashkëpunimi me Kuvendin, me institucionet e tjera të pavarura dhe me mediat, me qëllim që qytetarët të informohen në mënyrë të vazhdueshme për vendimmarrjet dhe ndikimin e tyre në mbrojtjen e interesit publik dhe të fondeve publike.

3.Të realizojë përditësimin dhe përmirësimin e katër manualeve kryesore, (Procedurat e Ankesave të Prokurimit Publik për Operatorët Ekonomikë, Manuali mbi Ankimin Administrativ për Procedurat e Prokurimit Publik për Autoritetet/Entet Kontraktore, Manuali i Përdorimit - Për Ankesë, Argument nga Operatorët Ekonomikë, Manuali i Përdorimit-Portali kpp.al/Llogaria e Autoritetit Kontraktor).

4.Të vijojë angazhimin në realizimin e seancave dëgjimore të hapura dhe transparente, me përfshirje të përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë dhe organizatave të shoqërisë civile të fushës.

5.Të vlerësojë mundësinë e ndërtimit të një platforme të identifikimit të risqeve për integritetin e procesit të prokurimit dhe të vendimmarrjes në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

6.Të mundësohet publikimi në faqen zyrtare i analizave periodike për vendimet e ankimuara në gjykatë, duke përfshirë identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në rezultatin e mbrojtjes ligjore.

7.Të përfshijë në vijim një informacion në raportin vjetor të institucionit nëse ka patur raste të deklarimit të konfliktit të interesit në vendimmarrje.

8.Të angazhohet në përmirësimin e publikimit të të dhënave bazuar në OCDS (Standardin e të Dhënave të Kontratave të Hapura).

9.Të vijojë me dhënien e kontributit në adresimin e problematikave të konstatuara në raporte të ndryshme të organizmave ndërkombëtar lidhur me aktivitetin e Komisionit.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025